



Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr.04/L-144 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt.22 Nëntor 2012; Vendimit të Kuvendit Komunal 01.Nr.7833 i datës 14.07.2009 për Lejimin e Këmbimit- Kompensimit të Pronës së Paluajtshme; nenit 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjiçanit, për qëllimin e rregullimit të infrastruktures rrugore të “Deponia e Mbeturinave” në fsh.Velekincë, pas Rekomandimit të Komitetit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, 01.Nr.35/2015 i dt.10.04.2015 dhe Rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur me datë 30.04.2015, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të rrugës publike “ Deponia e Mbeturinave” - Velekincë

1. Kuvendi i Komunës së Gjiçanit **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën private për nevoja të rrugës publike “ Deponia e Mbeturinave” – Velekincë.**
2. **Lejohet këmbimi i ngastrës kadastrale: P-70403006-00753-3, lloji i njësisë-parcelë, zona- rurale, me sipërfaqe prej 367 m², të vendi i quajtur “Lugi Mal”, Zona Kadastrale- Velekincë, lloji i shfrytëzimit – infrastrukturë, shfrytëzimi aktual i parcelës – rrugë private e pronarit : Nexhmedin (Sadik) Behluli nga Gjiçani, me vendbanim në Lagjen “ Dardania I” rruga III/26. Prona private e cekur më lartë të këmbëhet me pjesën e pronës komunale nga ngastra kadastrale : P-70403013-02114-1, lloji i njësisë parcelë, lloji pronës – shoqërore, zona urbane, sipërfaqja 537 m², vendi i quajtur “ Dardania I”, Zona Kadastrale Gjiçan, lloji i shfrytëzimit- tokë ndërtimore, shfrytëzimi aktual i parcelës – truall, e cila evidentohet në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës Gjiçan.**
3. Obligohet Kryetari i Komunës, që pas plotfuqishmërisë së këtij Vendimi të bëjë kërkesë Ministrisë për Financa-ZVPP për vlerësimin e pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i këmbimit dhe të lidhin Kontratë për këmbimin me pronarin privat të cekur në nenin II të këtij vendimi duke u bazuar në raportet e vlerësimit nga Ministria përkatëse.
4. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bënë parcelimin e ngastrës Komunale sipas raportit të vlerësimit dhe pas lidhjes së kontratës me Kryetarit të Komunës dhe pronarit privat të bënë regjistrimin e pronave të këmbyerë në Regjistrat Kadastral.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjiçanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjiçan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjiçan.
6. Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës.

01.Nr.016-41860
Gjiçan, më 30.04.2015

Kryesuesja e Kuvendit
/Valentina Bunjaku –Rexhepi/